**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education, and Science*

Ministria e Arsimit dhe Shkencës duke qenë pjesë e veprimeve ndërinstitucionale për adresimin e dhunës në familje u ka sygjeruar shkollave të realizojnë aktivitete sensibilizuese në parandalim të dhunës në familje.

Kështu sektori i arsimit i është përgjigjur fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit.

Roli i arsimit në parandalim është shtyllë e fuqishme që kontribuon nëpërmjet procesit të rregullt mësimor në aktivitetet shtesë të institucioneve edukativo arsimore. Mesazhet e fëmijëve janë reflektimi i ndërgjegjesimit që ata e arrijnë nëpërmjet shkollimit cilësor. Prandaj, në kuadër të kësaj fushate kemi pranuar raporte, evidenca dhe pamje të aktiviteteve shkollore, me dedikim për këtë fushë.

Në vijim po paraqesim disa nga fotot përfaqësuese të aktiviteteve të larmishme shkollore.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës u bën thirrje të gjitha subjekteve të institucioneve arsimore dhe jasht saj që të punohet me efikasitet në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje duke qëndruar brenda rolit tonë sipas legjislacionit në fuqi!

# "TEMA"

"Dhuna"
"dhe"
"Abuzimi"

Majlinda Salihu
Klasa: IX$^5$
Shkolla:
"Ahmet Hoxha-Ferizaj"
03/12/2020

# Dhuna dhe Abuzimi



## Si dhe lloji i tyre

Dhuna, përkufizohet nga "Organizata Botërore e Shëndetit", si përdorim i vullnetshëm i forcës apo edhe i fuqisë fizike, si kërcënim ose e apl--ikuar, kundër një personi (individi) ose në një komunitet duke pasur me gjasë rezult--ate ose mundësi në dëmtime, vdekje, pas-oja psikologjike, keqzhvillim, ose pamundësi megjithëse grupi është i vetëdijshëm që për--fshirja e "Përdorimit të forcës", në përkufi--zimin e vet, shtrihet përmbi kuptimit, ko-nvencional të fjalës.

Ne e dimë se pre e dhunës dhe e çdo lloj, ab--uzimi janë fëmijët dhe gratë. Shpeshherë, ata keqtrajtohen në mënyra të ndryshme dh u mohohet e drejta, e lirisë së fjalës. Atyre u mohohen të drejtat duke u torturuar nga

një njeri (person) ose grup personash (indi-
-vidësh), ku me një emër mund t'i quajmë
si: "Dhunues" dhe "Abuzues".



STOP DHUNËS NDAJ GRAVE!



STOP DHUNËS NDAJ FËMIJËVE!

# Dhuna Dhe llojet e saj

Dhuna përveç një përkufizimi, nënkuptohet edhe si fjalë me kuptime dhe definicione të ndryshme.

Dhuna ndahet në disa lloje:

**Dhuna fizike:** ky lloji dhune, nënkupton çdo formë të abuzimit fizik, duke përfshirë këtu rrahjen me mjete të ndryshme (goditjet me shuplaka dhe me mjete të tjera), shtrëngimet në fyt, kërcënimet me objekte të forta dhe me armë, kërcënimet me vrasje etj. Në kuadë të kësaj dhune, përfshihet: mohimi i nevojave elementare për jetesë (ndihmat mjeksore, ush-qimi, gjumi), përkatësisht çdo lloj akti, që ush-trohet, për t'a dëmtuar fizikisht, personin (individin), ku mbi atë ushtrohet dhuna.

STOP DHUNËN FIZIKE!

STOP AKTEVE FIZIKE!



DHUNA FIZIKE

"JETA ËSHTË MË E LUMTUR PA DHUNË"

**DHUNA PSIKOLOGJIKE:** Kjo, dhunë, përfshin çd
lloj akti, që ka për qëllim: frikësimin dhe perse
-utimin e personit, në formë të kërcënimeve
të natyrave të ndryshme, mbajtjes nën kontro
të rreptë të komunikimit apo edhe të lëvizjes,
izolimin apo mbylljen në shtëpi, kërcënimet pë
shkatërrimin e pronës, lëndimin e një personi t
dashur, poshtërimet, fyerjet verbale etj. Të gji
këto forma, klasifikohen si dhunë psikologjik
që kanë për qëllim të: ulin, degradojnë, posh
-rojnë dhe lëndojnë, personin në nivelin publik
dhe individual.



DHUNA PSIKOLOGJIKE

Dhuna seksuale: Kjo dhunë nënkupton, çdo lloj abuzimi, qoftë fizik apo edhe psikik, ndaj personit (Fëmijës dhe gruas), që ka për synim, kryerjen e marëdhiëneve seksuale me dhunë, pa pasur prezente, dëshirën e personit, apo partnerit, ku në raste të shumëta janë gratë. Këtu përfshihet, çdo lloj sulmi fizik ndaj, pjesëve seksuale të femrës dhe të mashkullit si dhe nënçmimet poshtëruese mbi baza seksuale.



STOP, NDAJ USHTRIMIT TË DHUNËS SEKSUALE NDAJ GJINISË FEMËRORE!

DHUNA EKONOMIKE: Në këtë dhunë, përfshihet çdo lloj abuzimi ose çdo lloj veprimi, që vë nën kontroll të ashpër apo privim ndaj të ardhurave të përbashkëta në familje, mohimin në skajshmëri të nevojave bazë për jetesë normale, refuzim për të kontribuar në pikëpa-mje financiare në familje... Në këto raste, ind-ividi ka mohime dhe kufizime, të së drejtës e kontrollit të të ardhurave, familjare si dhe shfrytëzimin e tyre reciprok, ku kjo gjë, shpie deri te varësia e plotë ndaj partnerit.




Dhuna në familje: Dhuna në familje, është një emërtim që nënkupton abuzimin ndaj një per-soni në familje, qoftë femër apo mashkull. Dhuna në familje shpreh raportin dhe kontrollin të ushtruar nga një person në tjetrin (Viktimë).

STOP DHUNËS NË FAMILJE!



NDALONI DHUNËN FAMILJARE, DUKE JETUAR NË QETËSI, E PËR TË PASUR NJË FAMILJE TË LUMTUR ME SHUMË HARMONI!

Hulumtuesit deri më tani, kanë konstatuar se viktimat më të shpeshta të dhunës janë: gratë dhe fëmijët. Kjo bën që personaliteti i tyre të, jetë i kërcënuar vazhdimisht. Në anën tjetër, shumë nga fëmijët që janë, viktima të dhunës janë edhe objekte të trafikimit, pasi që hulumtimet tregojnë, se shumica e tyre vijnë nga familjet e ç'rregulluara, nga familje e ndara, familjet që jetojnë me konflikte të vazhdueshme ose fëmijët pa përkujdesje solide institucionale.

"Çdo shoqëri demokratike krijon mekanizma të nevojshëm, duke parandaluar, çfarë do lloj dhu-ne familjare. Edhe Kushtetuta e Kosovës në kapitullin e dytë të saj udhëzon në parandali-min e çdo diskriminimi në baza gjinore si dhe ndalon ushtrimin e dhunës gjinore..."

# DHUNA GJINORE

## Seksi dhe gjinia

Njeriu nuk lind me rol gjinor të caktuar, seps rolet përcaktohen nga shoqëria. Andaj, një gje është e rëndësishme: (të bëhet dallimi në mes nocioneve "seks" dhe "gjini). Seksi u referohet ndryshimeve biologjike që ekzistojnë midis, femr-ave dhe meshkujve, kurse gjinia, ka të bëjë me rolin shoqëror të krijuar dhe të përcaktuar ng shoqëria, për femrat dhe meshkujt.



Përcaktimi i rolit gjinor nga shoqër për burrat dhe gratë, bën që këto të dytat të kenë kufizime në ushtri-min e të drejtave të tyre të garan-uara nga ato që quhen "të drejta të njeriut". Kufizimet mund të jenë të n-ryshme dhe nga kushdo, duke filluar nga fa-ilja, qysh si fëmijë, mjedise shoqërore, shkolla e më vonë edhe shoqëria. Për këtë qëllim, jan krijuar edhe politika, dhe janë hartuar doku-mente, për evitimin e diskriminimit në ba gjinore. Viktima [illegible] femrat. Dhe

DHUNA DHE ABUZIMI NDAJ FËMIJËVE

# Masat mbrojtëse

## Trafikimi




Përveç abuzimit dhe dhunës ndaj grave, ky ushtrim ndodh edhe tek fëmijët. Fëmijët, sot shumë shpesh, dhunohen dhe abuzohen në forma të ndryshme, duke u torturuar dhe keqtrajtuar (rrahur). Disa fëmijë, sot janë edhe pjesë e trafikimit dhe që detyrohen nga trafikantët për të shitur lëndë narkotike, si: (drogë, alkool etj), si dhe fitimet t'ua dërgojnë atyre, pa asnjë shpërblim. Të rriturit apo edhe trafikantët, i urdhërojnë dhe i detyrojnë me dhunë fëmijët, duke i torturuar ata për të dalur, në rrugë dhe për të kërkuar para e lëmoshë, duke u'a dërguar atyre. Disa fëmijëve, u'a marrin organet, shëndoshë e mirë e duke i vrarë ata, për t'i shitur organet e për të fituar para. Nga fëmijët, pre e trafikimit më së shumti janë femrat (vajzat e vogla, adoleshentet), të cilat bëhen viktima duke i mashtruar, e

këtë arsye janë krijuar politika të veçanta në shkallë ndërkombëtare, për të garantuar të drejtat e femrës, si dhe për të parandaluar të gjitha format e diskrim--inimit gjinor.

"Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj grave (ang. CEDAW), në nenin 1 të saj, diskriminimin gjinor, përkatësisht diskriminimin ndaj grave, konsider--on çdo kufizim të bërë në bazë gjinie, qëllimi i së cilës është të pengojë apo të mohojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin e roleve nga gratë, pa marrë parasysh se a janë të martuara apo çfarë statusi tjetër kanë ato."

• Por mos harroni se përveç viktimave të dhunës që janë gratë, në disa raste, pre e dhunës janë edhe burrat!



unicef | caritas | HANDIKOS – SHOQATA E PARAPLEGJIKËVE DHE E PARALIZËS SË FËMIJËVE TË KOSOVËS / ASSOCIATION OF PARAPLEGICS AND PARALYSED CHILDREN OF KOSOVA | Save the Children Kosova

DISA ORGANIZATA JOQEVERITARE DHE NDËRKOMBËTARE, QË KANË PËR SYNIM MBROJTJEN E FËMIJËVE NË BOTËN MBARË.




Të lutem mos më lëndo!

"Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve"
(54 nene dhe u miratua: 20 nëntor 198

duke i rrëmbyer, duke i shitur, transport-uar, droguar, blerë, frikësuar, persekutuar, kë-rcënuar, abuzuar e dhunuar seksualisht. Si dhe duke i forcuar për të kryer marëdhiëne seksuale, pa dëshirën, e tyre! Andaj ne dhe çdo kush tjetër, nuk duhet të gënjehemi e të mashtr-ohemi lehtë, nga të huajt, sepse më vonë mund ta pësosh keq!



TË PAPUNËT (TË VARFËRIT) SI PRE E TRAFIKIMIT!






STOP PUNËN E FËMIJËVE!

EDHE UNË JAM NJË QENIE NJERËZORE!

TË LUTEM MOS MË BËJ KEQ!



# Ese

## "Dhuna në familje"

• Dhuna në familje, konsiderohet sikur një plagë e vjetër e shoqërisë, ku shpesh herë ende e pambyllur, e cila i ka rezistuar zhvillimit që shoqëria ka bërë në mbarë botën, duke mos lënë pas në zhvillimin demokratik të shoqërisë shqipëtare. Në realitetin e padëshiruar është e pashmangshme, që çdo ditë të mos shënojë një tjetër viktime, femër, nënë, bashkëshorte apo motër! Përtej pikëpyetjeve të shumta që nuk marrin asnjëherë, përgjigjje për pjesëtarët e tjerë të familjes, arrestimit dhe dënimit përkatës të autorit, në shoqërinë shqipëtare, preferohet të jepen ide, rrethana faktike të përçuara në mënyrë të saktë, apo jo, biografi e thelluar e viktimës apo e autorit. E thënë më thjeshtë, pas krimit të rëndë përpara përballjes me drejtësinë, zhvillohet "Gjyqi Publik", i cili tenton të kategorizojë shoqërinë në individë që e përbëjnë vikti

-mën dhe në individë që për arsye nga më të ndryshmet përkrahin reagimin e rëndë të autorit. Dhuna në familje shpreh abuzimin ndaj një personi në familje, qoftë mashkull apo femër. Dhuna në familje shpreh raportin e abuzimit dhe të kontrollit të ushtruar nga një person ndaj tjetrit, ku ai person konsider-ohet si viktimë. Shpeshherë, dhuna në familje kuptohet, si rrahjet ndaj tjetrit, p.sh: e burrit ndaj gruas ose anasjelltas, apo e prindit ndaj fëmijës ose anasjelltas etj. Dhuna në familje përfshin, në vete, forma dhe trajta të ndry-shme, të cilat bëjnë pjesë disa lloje të dhunës, që klasifikohen, në dhunë: fizike, seksuale, psi-kologjike dhe ekonomike. Shpresoj, që dhuna me kohën nuk do të ushtrohet shumë shpesh, e të gjithë të shpëtojnë si pre e saj.

Majlinda Salihu IX^5
Shkolla "Ahmet Hoxha"
03/12/2020
"Dhuna dhe Abuzimi"

## *DHUNA NË FAMILJE*

*Dhuna është një veprim përmes të cilit një person ka për qëllim të lëndoj dikë. Ekzistojnë lloje të ndryshme të dhunës si; dhuna fizike, emocionale apo psikologjike, si dhe financiare. Dhuna fizike konsiderohet cdo vepër si goditja, shtyrja, grushtimi, shkelmimi etj. e cila ka për qëllim të lëndoj personin fizikisht. Dhunë emocionale apo psikologjike konsiderohet cdo vepër apo fjalë e cila ka për qëllim ta turpëroj personin, ta bëj atë të ndihet keq me veten, apo ta frikësoj atë sic janë ofendimet, presioni, kërcënimet etj. Ndërkaq, dhuna financiare ndodh kur dikush provon të kontrolloj burimet financiare të një personi tjetër pa lejen e personit. Të gjitha këto lloje të dhunës mund të jenë prezente në dhunën në familje. Dhuna në familje shfaqet zakonisht kur njëri ndër partnerët fillon të kontrolloj partnerin tjetër në fusha të ndryshme të jetës. Kjo, zakonisht ndodh për shkak se partneri në fjalë ka vetëbesim të ulët, ka xhelozi të tepërt, nuk mund ta kontrolloj veten, mirëpo gjithashtu edhe për shkak të mjedisit ku jetojnë familja dhe mentalitetit të shoqërisë. Deri vonë, në shoqërinë kosovare gratë/femrat janë parë si prona të dikujt. Fillimisht janë konsideruar pronë e babait e pastaj e bashkëshortit. Kjo me një mënyrë a tjetër ua ka dhënë të drejtën bashkëshortëve që të kontrollojnë gruan e si rrjedhojë edhe të ushtrojnë dhunë ndaj saj, duke çuar kështu në dhunë në familje. Fatmirësisht, tani mentaliteti kosovar po ndryshon dhe vajzat konsiderohen të barabartë me djemtë. Zakonisht, dhuna në familje fillon të shfaqet në mënyrë shumë të fshehtë si kritikat, fajësimi duke shkuar në forma më të rënda si goditja apo edhe vrasja.*

## Ese — Kundër dhunës në familje

Çdo njeri për jetën e tij mbrohet me ligj!

Por krahas parimit të përgjithshëm të mbrojtjes absolute të jetës në pikë të dispozitës është parashikuar në përjashtim të kontekstit "justifikues" kur privimi nga jeta vjen nga përdorimi i forcës, që është jo më shumë se absolutisht i domosdoshëm me qëllim përmbushjen e një ndër qëllimeve alternative që janë: së pari mbrojtja e çdo personi nga dhuna e paligjshme së dyti, kryerja e një arrestimi të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar ligjërisht dhe së treti, për të kundërshtuar në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje. Pavarësisht se trajtimi në këtë ese është parë në këndvështrimin e humbjes së jetës si pasoje e dhunës në familje e cila mund të jetë viktimë, dhe kryesisht mund të jetë femra. Çështja e dhunës në familje e cila mund të formësohet në mënyra të ndryshme nga dhuna fizike tek ajo psikologjike ose abuzimi verbal ... është një problem i përgjithshëm që shqetëson të gjitha shtetet antare dhe që nuk rezulton gjithmonë në sipërfaqe pasi që shpesh ndodh brenda mardhënieve ~~për~~ personale ose çifteve të mbyllura dhe nuk janë vetëm gratë të prekura. Duhet që ta stopojmë dhunën në familje!


Punoi: Natyrë Bajrami

Klasa: VII-4

sh.f.m.u-"Ahmet Hoxha"

Ferizaj

*Dhuna në familje në të shumtën e rasteve fillon midis partnerëve, mirëpo pastaj përfshihen edhe fëmijët, të cilët mund të jenë viktima direkte apo edhe indirekte. Fëmijët janë ata të cilët pësojnë më së shumti nga dhuna në familje. Fëmijët të cilët shohin prindërit duke u grindur dhe janë prezent përgjatë dhunës së prindërve ndaj njëri-tjetrit konsiderohen viktima të dhunës në familje. Këta fëmijë janë në rrezik më të madh që në të ardhmen të përjetojnë probleme të shëndetit fizik dhe mendor. Problemet e tilla përfshijnë lëndimet fizike përgjatë dhunës në familje, lëndimet që mund t'i shkaktoj fëmija vetes, stresi, ankthi, vetëbesimi i ulët, frikat etj. Gjithashtu, fëmijët që përjetojnë dhunë përgjatë fëmijërisë ka më shumë mundësi të bëhen të dhunshëm në të ardhmen si dhe kanë vëshirësi të krijojnë raporte me njerëz dhe kanë vështirësi të mësojnë. Ndaj, kur i mendojmë këto efekte negative të dhunës, ne si fëmijë duhet të kuptojmë prej tani rëndësinë e një familje të shëndoshë, ashtu që të vetëdijësojmë të gjithë përreth nesh dhe të krijojmë një shoqëri më të lumtur dhe pa dhunë për të gjithë fëmijët.*

***E punoi: Inna Berisha***

Kl - VII 4

Shf. m. u "Ahmet Hoxha"

# Dhuna në familje

:Ese:

Dhuna në familje- një aspekt që përdoret për dashuri, përkrahje, mbrojtje
por edhe një aspekt që përdoret për mosmarrveshje, asnjë përkrahje, probleme.
Fëmija është një qënie e pafajshme, kjo qënie është fyer, shtyer, përdoret dhunë.
Disa përpiqen, problemet ti mbajnë në zemrat e tyre të vogla që ka pasur
lëndime të mëdha. Një familje që nuk e ka përkrahur kurrë. Dhe çfar?
E ka gjuajtur në katër mure, ka përdorur dhunë fizike, ajo familje, ku më e keqja ka përfunduar
deri në vdekje i uritur duke munduar ti fsheh plagët!
Duke u përpiqur qe me një buzëqeshje ta mbuloj të gjithë botën.
Njerëz, persona, familje ju lutem ndoshta jemi të vogël vajzëapo djalë, i vogël, i madh,
jo secila familje ka të drejt në fyen për aspektin që jemi! Asnjë familje nuk ka të drejt.
Kemi imagjinatën një guxim të vogël që do të ngritemi dhe ta largojm dhunën familjare
NDALONI DHUNËN, LAJMET E RËNDA, nga fyerja deri tek vdekjet, sepse në
fund të fundit edhe në jemi krijesa njerëzore që marrim frymë.
Nuk ju mbushen syt me lot kur dëgjoni bërtima nga dhimbja, të shtrir për toke duke e
parë vdekjen përpara syve. Gjakun që po derdhet. JU LUTEM NDALONI!

E punoi: Erda Murati VII4
sh.f.m.u. "Ahmet Hoxha" - Ferizaj.

# Ese : Dhuna

Pavarësisht sa të civilizuar jemi dhe sa shoqëria ka zgjeruar dhunëti të ndryshme, qeniet njerëzore kanë akoma të njejtat gjene prej shumë vitesh. Nëse ndalemi mendojmë vetëm një minut se çfarë po ndodh në tërë botën në atë moment, do ta kuptojmë se të gjithë nuk janë në paqe. Dikush qesh nga lumturia, dikush qanë nga gëzimi apo frika e dikush hesht nga dhuna. Fatkeqësisht nuk gjindemi të gjithë në të njejtat situata. Një gjë e di se askush nuk mund të gjejë jetë të lumtur në dhunë. Shumë njerëz gjejnë dhunë në forma të ndryshme, e në momente të ndryshme. Ne duhet të themi fjalën tonë, por jo përmes dhunës, agresionit ose frikës. Të shprehim mendimet tona, të ngrihemi në këmbë për ndalimin e dhunës në tërë botën. Frika nuk është zgjidhje e duhur. Të jemi më të fortë se ata që ushtrojnë dhunë. Sot apo nesër, jo! Tani në këtë çast mund t'a thuash. Zëri mund të dëgjohet shumë lartë vetëm me arë të guximit!

E punoi: Mariza Beqiri IX-3

Sh.f.m.u. "Ahmet Hoxha"

Ferizaj.



Erisa Hasani Kl VII5 Shmu "Ahmet Hoxha" - Ferizaj

# DHUNA NË FAMILJE

-Termi "dhunë në familje" përdorët për të përshkruar një varg veprimesh dhe moskryerjeve të detyrav që ndodhin në marrdhënie të ndryshme. Në kuptimin e tij me të ngusht termi përdorët për të përshkruar incidente të sulmeve fizike, kur ato kanë formën e dhunës seksuale apo fizike. Ka njerëz që e përdorin termin "dhunë në familje" edhe në kuptimin e dhunës mendore dhe psikologjike, e cila mund të jetë fyerjet e përsëritur me fjalë, ngacmime, izolime. Format e dhunës mund të ndryshojnë nga njëra shoqëri në tjetrën. E përdorur në kuptim më të gjerë, dhuna në familje përfshin abuzimin ndaj fëmijëve, qoftë ai fizik, psikologjik, apo seksual, dhuna midis vëllezërve dhe motrave, abuzimi dhe braktisja e të vjetërve dhe keq trajtimi i prindërve nga fëmijët.

Dhuna në familje është konsideruar si një plag e vjetër e shoqërisë, shpesh herë ende e pambyllur, e cila i ka rezistuar zhvillimit që shoqëria ka bërë në mbarë botën. Në realitetin e padeshiruar është e pashmangshme që çdo ditë të mos shënoje një tjetër viktimë, femër, nënë bashkëshorte apo motër!

Anita Hyseni IX4

sh.f.m.u "Ahmet Hoxha"

NUK KUSHTON ASGJË TË JESH NJERI I MIRË

BËHU

bëhu

i

MIRË

mirë



STOP ABUZIMIT

# STOP DHUNËS FIZIKE



Diana Cerkini IX3 - Shkolla "Ahmet Hoxha" Ferizaj



E punoi: Erisa Rexhaj

Kl-VII4

Shfm. u "Ahmet Hoxha"

Ferizaj



Dad ♥



Mom ♥

Sh.f.m.u "Ahmet H

Ela Haliti



Sh.f.m.u - "Ahmet Hoxha"
Alberita Asllani Kl-IX-3.


STOP
Dhuna në familje !!!



Ajo është një GRUA
Është një NËNË
Është një MOTËR

RESPEKTO FEMRËN

ELSA KOSUMI

Ferizaj

Kl - IX-3



Dhuna shkakton probleme psiqike dhe fizike

Duron Papati - Kl VII5 SHfmu "Ahmet Hoxha" - Ferizaj



Dhuna nuk është zgjidhje

Duron Papazi - Kl VII5 Shfmu "Ahmet Hoxha" - Ferizaj



Stop dhunës fizike dhe mendore

Melisa Çerkini XI VII5 - SHMU "Ahmet Hoxha" - Ferizaj


SHOQËRIA NA KA MËSUAR QË TË MOS PËRDHUNOHEMI NË VEND QË TË MOS PËRDHUNOJNË
"JO DO TË THOTË "JO"
NË VEND QË TË MË GJYKOSH QË KAM KËRKUAR TË JEM. E PËRDHUNUAR "MË NDIHMO!"
SHMU:"AHMET HOXHA" E punoi Rita Regica IX-5
DHUNA GJINOR

# CHILDREN DON'T LIE ABOUT BEING SEXUALLY ABUSED. THEY ARE MADE TO LIE IN ORDER TO KEEP IT A SECRETE




TI JE E ARDHMJA

Në 38 shtete është e lejuar martesa e vajzës 10 vjeç. Përderisa burri i ofron kulmin e shtëpisë. Burri mund ta përdhunojë atë. Dhe shteti është në përkrahje e këtij veprimi. Çdo vit 75% e fëmijeve përjetojnë abuzim.

Më fal që i besova atij.

Më fal që shkova tek shtëpija e tij.

Më fal që se kuptova shpejt si ti

Më fal që më kapi duart të vogla të mi.

Më fal që më kërconoi.

Më fal që më përdhunoi

Më fal se isha vetëm fëmijë.

Më fal se do të jetojë me atë ditë të zi.

E punoi: Riza Reçica IX-5

SHMU: "AHMET HOXHA"




MY FAMILY


STOP
DHUNËS NË
FAMILJE !

Emri: Kaltrinë Kryeziu Data: 03/12/2020

"Dhuna në familje"

-Dhuna në familje është një problem serioz në shoqërinë shqiptare, gazetat dhe mediat pothuajse çdo ditë raportojnë raste rreth këtij fenomeni i cili në të vërtetë është vërtetë vështirë të trajtohet, por është akoma më e vështirë të raportohet. Studimet tregojnë se më së shumëti nga ky fenomen janë të prekura gratë dhe vajzat, të cilat e kanë të vështirë të tregojnë raste të tilla, jo sepse nuk dëshirojnë por kanë frikë. Ende më e vështirë është ta dish se edhe fëmijët janë pjesë e kësaj dhune, në familje, në shkollë edhe kjo dhunë ndaj tyre ndikon negativisht në shëndetin e tyre mendor, shkakton traumë dhe ata mendojnë që nuk janë të mjaftueshëm, nuk e meritojnë të jenë të lumtur, kanë vetbesim të ulët dhe fillojnë e humbin motivin edhe për mësim. Si pasojë e dhunës ka persona që kanë humbur edhe jetën dhe kjo është tmerrësisht e dhimbshme. Unë uroj që kjo plag të mbyllet sa më shpejtë të vetëdihsohemi si popull, si shoqëri sepse ky fenomen dita ditës po rritet.


DHUNA
"FRIKEN"
STOP
MOS MË DHUNO
JAM I/E PAFAJSHËM


"Ne fëmijët kemi të drejtë të jetojmë në familje
të shëndoshë"




Stop dhunës!